



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

KOLEGJI "BIZNESI"

Nr. 214-1/25 Data 27.06.2025
PRISHTINË

Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor në përputhje me nenin 5, pika 5 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 7, pikat 6, 7 dhe 8 të Statutit të Kolegjit Biznesi, ka miratuar me Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor me nr. 27/2025 këtë Rregullore për zhvillimi e aktiviteteve institucionale dhe akademike në mënyrë virtuale

RREGULLORE PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE INSTITUCIONALE DHE AKADEMIKE NË MËNYRË VIRTUALE

Neni 1

Objekti dhe Fusha e Veprimit

Kjo rregullore përcakton legjitimimin e funksioneve institucionale dhe akademike në vijim:

1. Rregullimi i zhvillimit të funksioneve brenda Kolegjit në mënyrë opcionale.
2. Përdorimi i platformave bashkëkohore për implementimin e funksioneve në mënyrë virtuale (online).
3. Zhvillimi në mënyrë virtuale (online) i mësimi, aktiviteteve, detyrave, ushtrimeve, prezantimeve, mbrojtjeve të temave të diplomës, testeve dhe provimeve.

Neni 2

Aktivitetet Akademike dhe Shkencore

1. Përfshirja e aktiviteteve mësimore-shkencore në mënyrë virtuale (online) në syllabuset e lëndëve përkatëse.
2. Zhvillimi i trajnimeve të ndryshme akademike në mënyrë virtuale (online).
3. Zhvillimi i mobiliteteve ndërkombëtare të studentëve, stafit akademik dhe administrativ në mënyrë virtuale (online).

Neni 3

Administrimi i Dokumentacionit dhe Proceseve

1. Përpunimi dhe pranimi i dokumentacionit në mënyrë digjitale, në përputhje me rregullat në fuqi në Republikën e Kosovës për mbledhjen dhe përpunimin e dokumentacionit të studentëve, stafit akademik dhe administrativ.
2. Zhvillimi i procesit të rekrutimit (regjistrimit të studentëve dhe stafit) në mënyrë virtuale (online).
3. Zhvillimi i të gjitha funksioneve të KLMSH-së, Bordit dhe të gjitha zyrave dhe niveleve në mënyrë virtuale (online).
4. Zhvillimi i shërbimit dhe funksioneve administrative në mënyrë virtuale (online).
5. Zhvillimi i funksionit të konsultimeve akademike, administrative dhe studentore në mënyrë virtuale (online).
6. Zhvillimi i funksionit të tutorëve në mënyrë virtuale (online).

Neni 4

Biblioteka

1. Zhvillimi i funksionit të bibliotekës dhe qasjes në mënyrë virtuale (online).

Neni 5

Menaxhimi Elektronik i Dokumentacionit

1. Ruajtja dhe koleksionimi i dokumentacionit në mënyrë elektronike.
2. Nënshkrimi dhe vulosja e dokumenteve në mënyrë elektronike.

Neni 6

Bashkëpunimi me Palët e Jashtme

1. Zhvillimi i takimeve me faktorët e jashtëm, industrinë, alumni dhe partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë në mënyrë virtuale (online).
2. Zhvillimi i konferencave shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare në mënyrë virtuale (online).
3. Zhvillimin e mobiliteteve në mënyrë virtuale (online)
4. Zhvillimi i proceseve të akreditimit në mënyrë virtuale (online).

Neni 7

Detyrimi për Përgatitjen e Rregullores


Të gjitha aktivitetet e lartëpërmendura, mundë të propozohen për implementim nga palët e interesit me lejen paraprake nga Dekani.

Neni 8

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga KLMSH.

Kryetari i KLMSH



Prof. Dr. Shyqeri Kabashi

